



Koalicioni Vak

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur

01 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2021

Përmbajtja:

| | |
|--|------|
| Raport i auditorëve të Pavarur.. | 3 |
| Pasqyra e Pozitës Financiare..... | 6 |
| Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve..... | 7 |
| Informata të përgjithshme | 8 |
| Shënimet e pasqyrave financiare..... | 9-14 |

Raport i Auditorëve te pavarur Drejtuar Kryesisë së “Koalicioni Vakat” Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik “Koalicioni Vakat” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “VAKAT”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2021, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe nformacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq 9-14

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare te vitit 2021 të subjektit “Koalicioni Vakat”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të fituar një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim te opinionit

- Subjekti Politik nuk ka plotësuar drejt pasurine, ekuitetin dhe detyrimet me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020, po ashtu vlerat e prezentuara në Pasqyra Financiare per ekuititin dhe detyrimet nuk mbështeten me dëshmi relevante ashtu sic kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Pas parasysh natyrën e shenimeve qe mban subjekti politik ne e kishim te pamundur te percaktojm korrigjimet e nevojshme me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020.
- Ashtu siç është deklaruar në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, kategoria Shpenzimet e fushatës, subjekti politik ka deklaruar vlerën prej 26,830.00 euro, përderisa vlera e përgjithshme e shpenzimeve të dy fushatave zgjedhore të deklaruara në raporte përmbanë shumë prej 37,557.30euro. Diferenca prej 10,727.30 euro tregon se shpenzimet e fushatës janë të nënvlerësuar. Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik dhe në mungesë të dokumentacionit mbështetës ne e kishim të pamundur të verifikojmë nëse shpenzimet e raportuara janë të sakta dhe prezantojnë drejt aktivitetin e SP.
- SP nuk posedon listën e detajuar të Aseteve Fikse dhe Inventarit të zyrës sipas standardeve të kontabilitetit. SP kishte njohur shpenzimet e zhvlerësimit në nivel të kategorisë, prandaj nuk kemi mundur të verifikojmë egzistencën dhe saktësin e shumës së paraqiturë si shpenzim i zhvlerësimit dhe vlerën e prezantuar te asetve me 31 Dhjetor 2021

Theksim i çështjes

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik në blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.

- Subjekti Politik nuk ka ndonjë rregullore të mbrendshme ku do të ishin specifikuar procedurat e funksionimit, në bazë të së cilës do të kishte funksionuar SP dhe do të ishin evituar parregullsitë.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.
- Gjatë verifikimit të shpenzimeve të fushatës-listat e vëzhguesve, kemi vërejtur se mungojnë nënshkrimet e personave që kanë pranuar meditet.
- Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur që për shpenzimet e ushqimit, reprezentacionit, komunikimit dhe karburantit, në shumicën e rasteve SP ka blerje me kupona fiskal dhe nuk ka dokumentacion relevant mbështetës, që do të mundë të arsyetonin dhe mbështesnin shpenzimet e ndodhura.
- Transaksionet me para të gatshme brenda Subjekteve Politike në koalicion, nuk janë specifikuar dhe regjistruar në librin e arkës të SP sipas destinimit dhe aktivitetit.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin

opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Besa Sahitaj Berisha
Auditore Ligjore
18 Tetor, 2023

Pasqyra e Pozitës Financiare

| Pasuritë | | Me 31 Dhjetor 2021 | Me 31 Dhjetor 2020 |
|--|---------|---------------------------|---------------------------|
| Pasuritë afatgjata | Shënimi | Shuma në Euro | Shuma në Euro |
| Toka, objektet dhe pajisjet | 5 | 1,103.93 | 1,471.91 |
| Pasuritë e paprekshme | | | |
| Pasuritë tjera afatgjata | | | |
| Total pasuritë afatgjata | | 1,103.93 | 1,471.91 |
| Pasuritë afatshkurtra | | | |
| Llogaritë e arkëtueshme | | | |
| Parapagimet | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 3 | | 2.22 |
| Pasuritë tjera afatshkurtra | | | |
| Total pasuritë afatshkurtra | | 0.00 | 2.22 |
| Total pasuritë | | 1,103.93 | 1,474.13 |
| Ekuiteti | | | |
| Fondet e akumuluar | | 1,103.93 | 1,474.13 |
| Suficiti / (deficiti) i vitit | | -18,425.00 | -12,550.00 |
| Total Ekuiteti | | -17,321.07 | -11,075.87 |
| Detyrimet | | | |
| Detyrimet afatgjata | | | |
| Huatë e pagueshme | | | |
| Të hyrat e shtyera | 5 | | |
| Gjithsej detyrimet afatgjata | | 0.00 | 0.00 |
| Detyrimet afatshkurtra | | | |
| Llogaritë e pagueshme dhe të tjera | 8 | 0.00 | 0.00 |
| Huatë e pagueshme | | | |
| Detyrimet tjera afatshkurtra | 9 | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej detyrimet afatshkurtra | | 18,425.00 | 12,550.00 |
| Gjithsej detyrimet | | 18,425.00 | 12,550.00 |
| | | | |
| Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet | | 1,103.93 | 1,474.13 |

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

| | Shënimi | Viti që përfundon me 31 Dhjetor | |
|--|---------|---------------------------------|------------------|
| | | 2021 | 2020 |
| Të hyrat | | | |
| Të hyrat nga buxheti | | 38,640.60 | 61,897.78 |
| Të hyrat nga anëtarësia | | | |
| Donacionet dhe kontributet në të holla | 3 | | 2.22 |
| Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime | 4 | | |
| Të hyrat e fushatës | | | |
| Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera | 5 | 367.98 | 1,011.58 |
| Të hyrat tjera | | | |
| Gjithsej të hyrat për vitin | | 39,008.58 | 62,911.58 |
| Shpenzimet | | | |
| Pagat dhe kompensimet | 2 | 12,927.60 | 12,801.60 |
| Shpenzimet e transportit | 2 | 383.00 | 1,236.00 |
| Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat | 2 | 2,343.00 | 9,853.00 |
| Shpenzimet e fushatës | 2 | 26,830.00 | 12,550.00 |
| Blerja e mallrave | 2 | 10,161.50 | 15,928.30 |
| Shpenzimet e përgjithshme | 2 | 2,842.09 | 2,962.91 |
| Shpenzimet e ndryshme | 2 | 1,946.39 | 5,739.88 |
| Gjithsej shpenzimet për vitin | | 57,433.58 | 61,071.69 |
| Suficiti / (deficiti) për vitin | | -18,425.00 | 1,839.89 |

1. Informata të përgjithshme

Koalicioni Vak është Subjekt politik i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Adresa e Subjektit Politik: Enver Haradinaj nr.48, Prizren

Kryetari i SP Koalicioni VAKAT për vitin 2021 është : z. Rasim Demiri

Zyrtar financiar : Emo Kurtishi

Pasqyrat financiare të subjektit politik janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari të vetme bankare në bankën Banka Ekonomike.

Koalicioni Vakat*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor, 2021***Shënimi 2. Shpenzimet**

| Shpenzimet | Shpenzimi në Euro | Pagesa në Euro | Borxhi i mbetur në Euro |
|---|------------------------------|---------------------------|--|
| Pagat dhe kompensimet | | | |
| Pagat dhe kompensimet, neto | 11,130.96 | 11,130.96 | 0.00 |
| Kontributet pensionale të punëmarrësit | 609.60 | 609.60 | 0.00 |
| Kontributet pensionale të punëdhënësit | 609.60 | 609.60 | 0.00 |
| Tatimet në të ardhura personale | 577.44 | 577.44 | 0.00 |
| Beneficionet tjera | | | 0.00 |
| Gjithsej | 12,927.60 | 12,927.60 | 0.00 |
| Shpenzimet e transportit | | | |
| Automjetet motorike të huazuara | | | 0.00 |
| Karburantet | 383.00 | 383.00 | 0.00 |
| Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj. | | | 0.00 |
| Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave | | | 0.00 |
| Çdo shpenzim tjetër i transportit | | | 0.00 |
| Gjithsej shpenzimet e transportit | 383.00 | 383.00 | 0.00 |
| Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat | | | |
| Lokali | | | 0.00 |
| Ushqimi | 1,088.00 | 1,088.00 | 0.00 |
| Aktivitete kulturore dhe rekreative | | | 0.00 |
| Radio dhe spotet televizive | | | 0.00 |
| Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta | 700.00 | 700.00 | 0.00 |
| Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave | 555.00 | 555.00 | 0.00 |
| Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat | 2,343.00 | 2,343.00 | 0.00 |
| | | | |

Koalicioni Vak*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor, 2021*

| Shpenzimet e fushatës | | | |
|--|------------------|------------------|--------------------------------------|
| Shpenzimet e fushatës | 26,830.00 | 8,405.00 | 18,524.00 |
| Gjithsej shpenzimet e fushatës | 26,830.00 | 8,405.00 | 18,524.00 |
| Blerja e mallrave | | | |
| Furnizimi i zyrës | 10,161.50 | 10,161.50 | 0.00 |
| Pajisjet të vogla | | | |
| Gjithsej blerja e mallrave | 10,161.50 | 10,161.50 | 0.00 |
| Shpenzimet e përgjithshme | | | |
| Qiraja e lokalit të zyrës | 1,400.00 | 1,400.00 | 0.00 |
| Telefoni, interneti dhe posta | 460.00 | 460.00 | 0.00 |
| Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat) | 614.11 | 614.11 | 0.00 |
| Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë | 367 | //////////////// | //////////////////////////////////// |
| Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime | | //////////////// | //////////////////////////////////// |
| Gjithsej shpenzimet e përgjithshme | 2,842.09 | 2,474.11 | 0.00 |
| Shpenzimet e ndryshme | | | |
| Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës | | | 0.00 |
| Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër | 1,946.39 | 1,946.39 | 0.00 |
| Gjithsej shpenzimet e ndryshme | 1,946.39 | 1,946.39 | 0.00 |
| Gjithsej shpenzimet | 57,433.58 | 38,640.60 | 18,425.00 |

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

| | Bilanci në fillim të vitit (kosto historike) | Blerjet gjatë vitit | Zhvlerësimi i akumuluar | Zhvlerësimi i vitit | Bilanci në fundë të vitit (vlera neto) |
|---|---|----------------------------|--------------------------------|----------------------------|---|
| Toka | | | | | |
| Objektet | | | | | |
| Veturat | | | | | |
| Pajisjet e zyrës | 1,839.89 | | 367.98 | 367.98 | 1,103.93 |
| Pajisjet e teknologjisë informative | | | | | |
| Pajisjet tjera | | | | | |
| Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet | 1,839.89 | | 367.98 | 367.98 | 1,103.93 |

Shenime tjera

| Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
| | | |
| | | |
| Gjithsej Llogarit e arkëtueshme | | |

| Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
| Paraja në bankë | | |
| Paraja në arkë | | |
| Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë | | |

| Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
| Furnitori 1 - regjistri | | |
| Furnitori 1 | | |
| Furnitori 1 | | |
| Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera | | |

| Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
| Detyrimet për paga dhe tatime | | |
| Detyrimet për qira | | |
| Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime | | |
| Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet) | | |
| Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra | | |

